



**PROCESVERBAL V/2026**

I mbajtur me rastin e mbledhjes së V (pestë) për vitin 2026 të Komitetit për  
Komunitete Suharekë

---

**Vendi:** KK Suharekë  
**Zyra:** Salla e Bordit të Drejtorëve  
**Data:** 26.05.2026  
**Ora :** 09:00

---

**Prezentë:**

*z.Nazim Shabanaj*  
*znj.Merita Basha*  
*z.Zek Berisha*  
*znj.Amira Sofra*  
*z.Aziz Bytyqi*  
*z.Urim Suka*

**Të pranishëm tjerë:**

Xheladin Sadikaj- Zyrtar për Kthim dhe Komunitete  
Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore  
Zyra për informim  
Përfaqësues i OSBE-së  
Përfaqësues i LMT-së

Mungon;  
*Znj. Shkendije Shabanaj-Kryesuese*

Në mnuges të Kryesueses mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Nazim Shabanaj i cila propozoi këtë:

### **Rend Dite**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve ‘Emblema e artë’, ‘Skenderbeu’,dhe mirënjohjen ‘13 Qershori’;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit të ankesave për bursa për nxënës dhe student;**
- 5. Të ndryshme;**

**Nazim Shabanaj-** Përshëndet të pranishmit dhe i njofton me rendin e ditës.E hedh në votim rendin e dites:

**Unanimisht miratohet**

#### **Pika1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Nazim Shabanaj-**e hap debatin

**Urim Suka-**përshendetje për të gjithë,në procesverbal shkruan që është mbajtur në sallën e bordit mirpo është mbajtur në Zyrën e Kryetarit,dhe propozoj që herav të tjera të mos mbahet në Zyrën e Kryetarit por të gjendet një alternativ tjetër.

**Nazim Shabanaj-**e hedhë në votim

**Miratohet me vërejtje**

#### **Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**

**Avni Bytyçi-**bëhet fjal për formimin e komisionit për të zhvilluar procedurat për lokalin që gjendet në rr.Brigada 123 te libraria Edori vendimi paraprak është marrë para dy muaje,konfirmimi ligjshmëris ka ardh prej Ministries tash jemi të obligum me formu komisionin.

**Nazim Shabanaj-** e hedhë në votim

**Unanimisht miratohet**

**Pika3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve ‘Emblema e artë’, ‘Skenderbeu’,dhe mirënjohjen ’13 Qershori’;**

**Avni Bytyçi**-këto propozime kan ardh,një nga Kryetari disa të tjera nga Shoqata e Veteranëve të luftës dhe Invalidëve të luftës dhe familjëve të Dëshmorëve dhe dy nga Kryesit e Fshatrave.

**Nazim Shabanaj**-e hedhë në votim

**Unanimisht miratohet**

**Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit të ankesave për bursa për nxënës dhe student;**

**Avni Bytyçi**-edhe këtu bëhet fjal për komisionin për shqyrtimin e ankesave për bursa,para dy muaje është marr vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin e propozimeve për bursa,ndërsa sipas rregullores e kemi obligim ligjor që ta formojm edhe një komision për shqyrtimin e ankesave kur ka pa kënaqësi nga ana e komisionit kur bëhet shqyrtimi i aplikacioneve për bursa.

**Urim Suka**-përshendetje për të gjithë,kur jemi te projekt-vendimi të cilin e kemi këtu para vetes u mundova me lexu dhe pash që te neni 4 është një gabim profesional ose teknik mandati anëtarëve të komisionit komunal aksionar ky nuk është komision komunal aksionarëve por është komision të ankesave për bursa.

**Avni Bytyçi**-faleminderit për korigjimin,kët çështje e rregulloj.

Takimi përfundoi: 09:15